R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.61/2012, "PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", propozohet në kuadër të Paketës Fiskale 2027 dhe ka në fokus angazhimet e marra nga Republika e Shqipërisë në kuadër të integrimit në Bashkimin Evropian për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kapitulli 16 "Tatimet", për përafrimin e mëtejshëm me *acquis* në fushën e akcizave.

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është propozimi i kalendarit të ri të akcizave për duhanin dhe nënproduktet e tij, duke qenë se kalendari aktual përfundon në dhjetor 2026, duke synuar përafrim të mëtejshëm me direktivën e Këshillit 2011/64/EU, datë 21 qershor 2011, "Mbi strukturën dhe normat e akcizës që zbatohen për duhanin e përpunuar (kodifikim)", e cila, ndër të tjera, përcakton edhe nivelet minimale të akcizës për të gjitha kategoritë e duhanit të përpunuar.
Nëpërmjet këtij kalendari synohet konsolidimi i të ardhurave nga akciza, ruajtja e qëndrueshmërisë fiskale dhe krijimi i kushteve për arritjen graduale të niveleve minimale të taksimit të parashikuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian, duke mundësuar një tranzicion të qëndrueshëm dhe të përshtatur me kushtet ekonomike e fiskale të vendit.

Gjithashtu, projektligji ka si qëllim shtimin e produkteve të reja në kategorinë e duhanit dhe nënprodukteve të tij, të cilat rezultojnë të pranishme në treg dhe për të cilat është evidentuar nevoja për rregullim.
Një tjetër propozim i këtij projektligji, lidhet me ndryshimin e njësisë matëse të taksimit të biodiezel, nga lekë për kilogram, në lekë për litër.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT AKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji është hartuar në kuadër të angazhimeve të Republikës së Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit kombëtar me direktivat e Bashkimit Evropian, si pjesë e angazhimit strategjik për integrimin evropian. Ky projektligj synon përafrimin e mëtejshëm me direktivën e Këshillit 2011/64/EU, datë 21 qershor 2011, "Mbi strukturën dhe normat e akcizës që zbatohen për duhanin e përpunuar (kodifikim)".

Gjithashtu, ky projektligj është në përputhje edhe me objektivat dhe masat e parashikuara në Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave dhe planin e veprimit 2024-2027, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.847, datë 26.12.2024, e cila përcakton reformat në fushën e politikave tatimore, si dhe të administrimit tatimor dhe doganor, me synim rritjen e të ardhurave buxhetore, përmirësimin e efektivitetit të administrimit fiskal dhe forcimin e konsolidimit të financave publike. Në kuadër të shtyllës së rishikimit të politikës tatimore, propozohet kalendari i ri i akcizës për produktet e duhanit për periudhën 2027–2033, me qëllim sigurimin e një rritjeje të parashikueshme dhe graduale të niveleve të taksimit, në përputhje me objektivat e politikës fiskale dhe të shëndetit publik.

Kalendari aktual i akcizës (2022-2026) ka shërbyer si një platformë e mirë për stabilitetin dhe parashikueshmërinë e të ardhurave buxhetore nga akciza për produktet e duhanit. Gjatë periudhës 2022-2026, akciza e cigareve u rrit çdo vit sipas një skeduli të parashikuar në ligj, konkretisht, nga 6750 lekë/1000 fije në 7000 lekë/1000 fije më 1 janar 2023; 7250 lekë/1000 fije më 1 janar 2024; 7500 lekë/1000 fije më 1 janar 2025 dhe 7750 lekë/1000 fije më 1 janar 2026, siç është edhe aktualisht.

Direktiva e Këshillit 2011/64, datë 21 qershor 2011, mbi strukturën dhe normat e akcizës, që zbatohen për produktet e duhanit të përpunuar, përcakton nivelet minimale të akcizës për këto produkte, si më poshtë:

Direktiva e Këshillit 2011/64/EU	
Cigaret	90 euro për 1000 fije
Cigaret dhe Cigarillo	12 euro për 1000 copë, ose kilogram
Duhan i prerë imët për tymosje i destinuar për dredhjen e cigareve	60 euro për kilogram
Duhane të tjera për tymosje	22 euro për kilogram

Shqipëria ka arritur përafrim të plotë me kërkesat e direktivës 2011/64/BE për produktet puro, cigarillo, duhan i prerë imët për tymosje (import) dhe duhan tjetër për tymosje. Ndërkohë, për cigaret, si dhe për duhanin e prerë imët për tymosje dhe shisha/nargjilen e prodhuar në vend, nivelet aktuale të akcizës mbeten nën nivelet minimale të përcaktuara nga direktiva. Gjithashtu, për produktin cigare

nuk zbatohet ende komponenti proporcional (*ad valorem*), i cili përbën një nga elementet e strukturës së akcizës, sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian. Konkretisht, në pikën 2, të nenit 9, të direktivës, përcaktohet se taksimi i cigareve përbëhet nga:

(*a) a specific excise duty per unit of the product;*
(b) an ad valorem excise duty calculated on the basis of the maximum retail selling price;
(c) a VAT proportional to the retail selling price.

Gjithashtu, sipas pikës 2, të nenit 10, përcaktohet:

From 1 January 2014, the overall excise duty on cigarettes shall represent at least 60 % of the weighted average retail selling price of cigarettes released for consumption. That excise duty shall not be less than EUR 90 per 1 000 cigarettes irrespective of the weighted average retail selling price.

Kalendari i ri i propozuar për duhanin dhe nënproduktet e tij, i hartuar me asistencën e ekspertëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, merr parasysh strukturën e sistemit tonë fiskal. Ndryshe nga shumë vende evropiane, buxheti i shtetit shqiptar mbështetet kryesisht në taksat indirekte, veçanërisht taksat e konsumit, në vend të taksave të drejtpërdrejta të të ardhurave personale ose fitimeve të korporatave. Akcizat, përfshirë ato mbi cigaret/duhanin, luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e të ardhurave buxhetore dhe në mbështetjen e objektivave të politikës fiskale. Si të tilla, çdo rregullim i taksës së akcizës, përfshirë edhe këtë kalendar, hartohet duke pasur në fokus, por jo vetëm, rekomandimet ndërkombëtare, kryesisht ato të Bashkimit Evropian, duke siguruar të ardhura të qëndrueshme dhe njëkohësisht stabilitetin fiskal. Gjithashtu, ky kalendar mban në konsideratë elasticitetin e çmimeve të produkteve të duhanit në mënyrë që të sigurojë stabilitetin e volumeve të tregut të ligjshëm dhe parandalimin e informalitetit.

Kalendari i ri shërben si parakusht për zbatimin e plotë të kuadrit legjislativ të BE-së, konkretisht, të nivelit minimal të akcizës mbi cigaret prej 90 eurosh për 1 000 cigare, si dhe harmonizimin e strukturës së taksimit përmes aplikimit të komponentit proporcional (*ad valorem*). Kjo qasje e rritjes graduale të akcizës ka si qëllim shmangien e ndikimeve negative, që mund të sjellë harmonizimi i menjëhershëm i niveleve të akcizës me ato të aplikuara nga Bashkimi Evropian. Konkretisht, pasojat negative që do të shkaktonte një rritje e tillë mund të reflektoheshin në rritjen e tregut gri dhe tregtisë së paligjshme të produkteve të duhanit dhe, rrjedhimisht, në rrezikimin e stabilitetit të të hyrave publike, si dhe mundësinë e falimentimit të prodhuesve vendas të produkteve të duhanit.
Sipas modelit ekonometrik të përdorur për hartimin e kalendarit, për të përmbushur standardin e BE-së, është propozuar një rritje e akcizës specifike të

cigareve me rreth 350 lekë në vit, nga viti 2027 deri në vitin 2030, së bashku me aplikimin e komponentit *ad valorem*, duke filluar me 2% në vitin 2030 dhe duke u rritur me 1% çdo vit deri në vitin 2033.

Vitet	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**	**2031**	**2032**	**2033**
Akciza specifike (lekë/1000 fije) (lekë/1000 fije)	7,750	8,100	8,450	8,800	9,150	9,150	9,150	9,150
Rritja vjetore (lekë)	250	350	350	350	350			
Akciza Ad valorem (% e çmimit maksimal të shitjes me pakicë)					2%	3%	4%	5%
Total akcizë (lekë/1000 fije)	7,750	8,100	8,450	8,800	9,541	9,767	10,010	10,275

Kjo rritje, e parashikueshme dhe afatgjatë e niveleve të akcizës për periudhën 2027-2033, krijon edhe një kuadër më të qëndrueshëm për planifikimin e veprimtarisë ekonomike. Ky propozim është në përputhje edhe me objektivat e shëndetit publik, lidhur me ndikimin që produktet e duhanit kanë në shëndetin e popullsisë.

- Është propozuar ndryshimi i emërtimit të kategorisë T401 nga "Nikotinë" në "Produkte të destinuara për thithje pa djegie", si një nevojë për të pasqyruar më saktë natyrën dhe gamën e produkteve që përfshihen në këtë kategori. Përfshirja në kategorinë T401 nuk përcaktohet vetëm nga prania e nikotinës, por kryesisht nga funksioni dhe përdorimi i tyre, pra janë produkte të destinuara për thithje pa djegie.
  Ky propozim synon të eleminojë kufizimin artificial tek kjo kategori vetëm te produktet që përmbajnë nikotinë, ndërkohë që në treg ka produkte pa nikotinë (p.sh. lëngje për pajisje elektronike, që nuk përmbajnë nikotinë), të cilat sipas funksionit janë të njëjta dhe duhen trajtuar njësoj si dhe mundësinë për shmangie fiskale. Emërtimi i propozuar "Produkte të destinuara për thithje pa djegie" reflekton më saktë logjikën e klasifikimit të këtyre produkteve dhe është në përputhje edhe me përmbajtjen e notave shpjeguese për produktet e klasifikuara në kreun 2404 të Nomenklaturës së Kombinuar, sipas të cilave parashikohet se, "Produkte që përmbajnë duhan, duhan të rindërtuar, nikotinë, ose zëvendësues të duhanit ose nikotinës, të destinuara për t'u thithur pa djegie; produkte të tjera që përmbajnë nikotinë të destinuara për thithjen e nikotinës në trupin e njeriut...".

- Po në këtë kuadër, është bërë plotësimi i kategorisë T401 me një nënkategori të re të akcizueshme për produktet e destinuara për thithje pa djegie me nikotinë që nuk përmbajnë duhan ose duhan të rindërtuar, me një produkt të ri me specifika të ndryshme nga ato të produkteve, që aktualisht janë të parashikuara në ligjin për akcizat. Këto janë produkte të destinuara për thithje pa djegie me nikotinë që nuk përmbajnë duhan, por zëvendësues të tij, që në vende të Bashkimit Evropian dhe të rajonit janë klasifikuar në kodin tarifor 2404 12 00.

Në listën e kodeve të produkteve të duhanit, sipas ligjit të akcizës, niveli i akcizës është aktualisht i përcaktuar vetëm për produktet me nikotinë të lëngshme, me njësi taksimi në mililitra. Duke qënë se, produkti i ri, referuar karakteristikave përshkruese përmban nikotinë (por jo nikotinë lëng), zëvendësues duhani dhe jo duhan, propozohet të shtohet si një zë i ri brenda kategorisë T401 të produkteve të duhanit me qëllim përcaktimin e nivelit të akcizës me njësi matëse në kilogram. Trajtimi fiskal për këtë nënkategori propozohet në të njëjtin nivel me produktet e duhanit me ngrohje, pasi paraqesin karakteristika të ngjashme në pamje, përdorim dhe funksion, pavarësisht se produkti i ri përmban zëvendësues të duhanit dhe jo duhan. Ky propozim është gjithashtu në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, sipas së cilit nuk bëhen dallime ndërmjet produkteve për thithje pa djegie që përmbajnë duhan dhe atyre që përmbajnë vetëm nikotinë. Konkretisht, notat shpjeguese të kreut 2404 parashikojnë se, në këtë kategori përfshihen produktet që përmbajnë duhan, duhan të rindërtuar, nikotinë, si dhe zëvendësues të duhanit ose nikotinës, të destinuara për t'u thithur pa djegie. Përfshirja e kësaj nënkategorie në kategorinë T401, siguron trajtim të njëjtë fiskal për produkte me karakteristika dhe funksione të ngjashme, si dhe plotëson një boshllëk ekzistues në legjislacionin e akcizës.

Përfshirja e këtij produkti në listën e mallrave me akcizë, eventualisht pritet të sjellë rritjen e të ardhurave buxhetore, në përputhje me volumin e tregut dhe nivelin e konsumit të tij.

- Po në kategorinë T401, propozohet shtimi i produkteve me kod tarifor 2404 19, me përshkrim "*produkte të destinuara për thithje pa djegie, që nuk përmbajnë duhan ose duhan të rindërtuar dhe që nuk përmbajnë nikotinë*" (vape pa nikotinë), sipas klasifikimit të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

  Në mungesë të taksimit të produkteve pa nikotinë, tregu orientohet drejt këtyre produkteve, të cilat ofrojnë të njëjtën përvojë konsumatore si produktet me nikotinë, por me kosto me të ulët. Përfshirja e tyre si produkt akcize ndihmon në shmangien e konkurrencës së padrejtë, zgjerimin e bazës së tatueshme në një segment tregu në rritje dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së të ardhurave fiskale. Gjithashtu, nga këndvështrimi i shëndetit publik, produktet pa nikotinë, ndonëse shpesh reklamohen si të padëmshme, kontribuojnë në normalizimin e sjelljes së inhalimit dhe mund të nxisin kalimin drejt produkteve me nikotinë ose cigareve tradicionale. Përmes aplikimit të akcizës përcillet një mesazh i qartë shëndetësor dhe edukativ, në linjë me trajtimin e produkteve të tjera të kontrolluara (duhan, alkool).

  Niveli i akcizës për lëngjet e cigareve elektronike dhe produktet vape pa nikotinë është propozuar të jetë rreth 45.5% më i ulët se ai i produkteve përkatëse me nikotinë. Ky propozim merr në konsideratë peshën që zë niveli

më i ulët i akcizës i aplikuar në vendet e BE-së, në nivelin e akcizës po për këtë produkt, por që përmban nikotinë.

Për sa rezulton nga të dhënat e importit për vitin 2025 dhe 9-mujorin e vitit 2026, të përcjella nga administrata doganore, ekziston një volum i konsiderueshëm tregu për këto produkte, çka kontribuon në sigurimin e të ardhurave shtesë buxhetore.

- Pjesë e ndryshimeve të propozuara për kategorinë T401 "Nikotinë", është edhe ndarja më vete e nënkategorisë "Qeset me nikotinë" (*Nicotine Pouches*) nga kategoria me kod tarifor 2404 91.
  Këto produkte konsiderohen si një zhvillim modern i produkteve tradicionale të duhanit për përdorim oral dhe tregtohen në aroma të ndryshme dhe me përqendrime të ndryshme të nikotinës. Sipas OECD-së, në kategorinë e produkteve të nikotinës përfshihen edhe qeset me nikotinë, të cilat janë qese të vogla që vendosen ndërmjet buzës dhe mishit të dhëmbëve dhe çlirojnë nikotinë.
  Një numër i konsiderueshëm i vendeve të Bashkimit Evropian aplikojnë akcizë për produktin qese me nikotinë. Aktualisht, sipas ligjit për akcizat, kjo nënkategori përfshihet në kategorinë "Produkte duhani për përdorim oral" (CN 2404 91) me një nivel akcize 8750 lekë/kg. Ndërkohë, në shumicën vende, akciza mbi "qeset e nikotinës për përdorim oral" është ndjeshëm më e ulët për shkak të profilit të tyre më pak të dëmshëm. Konkretisht, në Itali, akciza mbi qeset me nikotinë është 22 €, në Greqi 50 €, në Mal të Zi 60 €, Kosovë 35 € dhe në Serbi 43 €.
  Në këto kushte, është vlerësuar dhe propozohet që nënkategoria "Qeset me nikotinë" pjesë e kategorisë T401 (CN 2404 91) të evidentohet si nënkategori më vete me nivel akcize, respektivisht, më të ulët sesa niveli aktual, konkretisht 3500 lekë/kg në vitin 2027 dhe me një rritje 20% për çdo vit.

- Me anë të këtij projektligji është propozuar edhe ndryshimi i mënyrës së llogaritjes së akcizës për produktet e nargjiles me duhan, duke kaluar nga taksimi vetëm mbi sasinë e duhanit në produkt, në taksimin mbi peshën totale të produktit të përfunduar. Aktualisht, baza e tatimit kufizohet vetëm te duhani, ndërsa përbërës të tjerë si melasa, glicerina dhe aromat nuk merren në konsideratë. Sipas direktivës 2011/64/BE, për produktet e nargjiles nuk parashikohet ndarje e bazës së tatimit sipas përbërësve të përzierjes. Gjithashtu, në notat shpjeguese të Komisionit Evropian, përcaktohet se "nargjile" është produkti që përbëhet nga përzierjet e duhanit, melasë ose sheqerit, të aromatizuara me fruta, glicerinë, vajra aromatikë dhe ekstrakte, pra e gjithë masa e përzier konsiderohet si nargjile dhe që konsumohet nga përdoruesi.

  Ndryshimi synon përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me Direktivën 2011/64/BE për kategorinë "other smoking tobacco", me nivelin minimal të akcizës prej 22 euro/kg. Me qëllim arritjen e këtij niveli minimal të

taksimit për produktet e nargjiles me duhan është propozuar një kalendar i rritjes graduale të akcizës për periudhën 2027-2033 (sipas shtojcës nr.1 që i bashkëlidhet këtij projektligji). Rritja graduale vlerësohet si qasje më e përshtatshme për të mundësuar përshtatjen e tregut, duke siguruar njëkohësisht përmbushjen e detyrimeve të harmonizimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

E njëjta logjikë si më sipër është edhe për produktin shisha/nargjile me duhan të kultivuar në Shqipëri, për të cilën është parashikuar të ndryshohet baza e tatimit (akcizë mbi peshën totale të produktit të përfunduar), sipas një kalendari të rritjes graduale të nivelit të akcizës, me qëllim arritjen e nivelit minimal të parashikuar nga direktiva, si edhe unifikimin e tarifës me produktet e importit.

- Gjithashtu është propozuar që në kategorinë T403, të shtohet produkti "shisha/nargjile pa duhan", me kod tarifor 2403 99 90, dhe një kalendar i rritjes graduale të akcizës, për periudhën 2027-2033. Ky propozim mbështetet në faktin se, produkti ka të njëjtën mënyrë përdorimi, destinacion dhe funksion si shisha/nargjilja me duhan, pavarësisht mungesës së duhanit në përmbajtje të tij. Për këtë arsye, propozohet që trajtimi fiskal i tyre të jetë i njëjtë, për kilogram produkti, me qëllim shmangien e diferencimeve fiskale, që mund të krijohen vetëm për shkak të zëvendësimit të duhanit me përbërës të tjerë. Përfshirja e këtij produkti në listën e mallrave me akcizë synon të parandalojë edhe mundësitë për shmangie nga detyrimet e akcizës përmes zëvendësimit të produkteve me duhan me produkte pa duhan.

- Në kuadër të ndryshimeve të propozuara më sipër, lind i nevojshëm edhe ndryshimi i nenit 18 "Mënyra e llogaritjes", me qëllim evidentimin e ndryshimit të strukturës së taksimit të cigareve kundrejt produkteve të tjera të akcizës.
- Një tjetër propozim i projektligjit lidhet me përcaktimin e përkufizimit (në nenin 78 të ligjit) të prodhuesit të produkteve të duhanit, si person përgjegjës, jo vetëm për prodhimin e produkteve të duhanit, por edhe për përcaktimin e çmimit maksimal të shitjes me pakicë, në përputhje të plotë me pikën (7) të direktivës 2011/64/BE.
- Gjithashtu, propozohen ndryshime në nenin 79 "Detyrimet", lidhur me strukturën dhe nivelin e akcizës për cigaret, ku si element i bazës së taksimit, krahas bazës ekzistuese të llogaritjes së akcizës për cigaret prej 1000 copë/fijesh, përfshihet edhe çmimi maksimal i shitjes me pakicë që deklarohet nga prodhuesit dhe importuesi, në funksion të aplikimit të komponentit proporcional (*ad valorem*) të akcizës nga data 1 janar 2030. Po në këtë dispozitë, ndër të tjera, është transpozuar rregulli i direktivës së BE-së për nivelet minimale të akcizës prej 90 eurosh për 1 000 cigare dhe barrës totale të akcizës, e cila duhet të përfaqësojë të paktën 60% të çmimit mesatar të ponderuar të shitjes me pakicë, sipas afateve të kalendarit të propozuar.

Këto propozime përafrojnë nenin 7 (1) dhe (2), 8 (1) dhe (2), 9, 10 (2) dhe 15 (1) të direktivës 2011/64/BE, sipas tabelës së përputhshmërisë që shoqëron këtë projektligj.

- Pjesë e projektligjit është edhe propozimi për taksimin e dieselit të misheluar me një përqindje bio (biodiesel), që i përket kategorisë E460, duke përcaktuar që njësia matëse e taksimit të jetë litër dhe jo kilogram.

  Produkti (E460) aktualisht taksohet për kilogram, ndërkohë që është i përftuar nga mishelimi i dieselit (E440) me acidet yndyrore (E920), të cilët e kanë njësinë matëse të taksimit në litër. Ky propozim është në linjë edhe me direktivën e Këshillit 2003/96/KE, datë 27 tetor 2003, për ristrukturimin e kuadrit të Komunitetit për taksimin e produkteve energjetike dhe të energjisë elektrike.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDËS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, dhe propozohet në kuadër të Paketës Fiskale 2027.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUITAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", synon të përafrojë ligjin nr.61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me direktivën e Këshillit 2011/64/EU, datë 21 qershor 2011, "Mbi strukturën dhe normat e akcizës që zbatohen për duhanin e përpunuar (kodifikim)".

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 5 nene, të cilat lidhen me ndryshimin e ligjit nr.61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me qëllim përafrimin e plotë me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e akcizave, konkretisht, me direktivën e Këshillit 2011/64/EU, si më poshtë vijon:

Në nenin 1 parashikohet se, pika 1, e nenit 18 "Mënyra e llogaritjes", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Akciza është një taksë specifike, me përjashtim të akcizës së cigareve, e cila përcaktohet sipas nenit 79, të këtij ligji.".

Në nenin 2 parashikohet se, pas pikës 7, të nenit 78 “Përkufizime”, të shtohet pika 8, me këtë përmbajtje:

“8. “Prodhues i produkteve të duhanit” është një person fizik ose juridik që prodhon produkte duhani dhe përcakton çmimin maksimal të shitjes me pakicë.”.

Në nenin 3 parashikohet se, në nenin 79 “Detyrimet”, bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Baza për llogaritjen e akcizës për cigaret është 1000 copë/fije dhe çmimi maksimal i shitjes me pakicë, ndërsa për purot dhe cigarillot është kg.”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8, me këtë përmbajtje:

“3.Akciza për cigaret përbëhet nga një komponent specifik, i përcaktuar në një shumë të caktuar për një sasi prej 1000 copë/fije dhe nga data 1 janar 2030 edhe nga një komponent proporcional (*ad valorem*), i llogaritur si përqindje e çmimit maksimal të shitjes me pakicë të cigareve.

4. Çmimi maksimal i shitjes me pakicë i cigareve të hedhura për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë është çmimi i vendosur për çdo markë të cigareve nga prodhuesit dhe importuesit, i cili përfshin akcizën, taksën doganore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

5. Prodhuesit dhe importuesit deklarojnë çmimin maksimal të shitjes me pakicë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, jo më vonë se 10 ditë përpara hedhjes për konsum të cigareve. Cigaret nuk mund të shiten me çmim të shitjes me pakicë më të lartë se çmimi maksimal i deklaruar.

6. Nga data 1 janar 2030, akciza totale (akciza specifike dhe proporcionale (*ad valorem*) duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar) për cigaret nuk do të jetë më e ulët se 90 euro ekuivalente në lekë për 1 000 copë/fije. Nga data 1 janar 2033, totali i akcizës (akciza specifike dhe proporcionale (*ad valorem*), duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar) për cigaret duhet të jetë të paktën 60% e çmimit mesatar të ponderuar të shitjes me pakicë të cigareve të hedhura për konsum dhe jo më pak se 90 euro ekuivalente në lekë për 1 000 copë/fije, pavarësisht nga çmimi mesatar i ponderuar i shitjes me pakicë të cigareve të hedhura për konsum.

7. Çmimi mesatar i ponderuar i shitjes me pakicë përcaktohet jo më vonë se data 1 mars e çdo viti dhe llogaritet duke marrë në konsideratë vlerën totale

të të gjitha cigareve të hedhura për konsum gjatë vitit kalendarik të mëparshëm, bazuar në çmimin e shitjes me pakicë që përfshin të gjitha taksat, pjesëtuar me sasinë totale të cigareve të hedhura për konsum gjatë asaj periudhe.

8. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen procedurat për zbatimin e këtij neni.".

Në nenin 4 parashikohet që shtojca nr.1, "Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë", bashkëlidhur ligjit, zëvendësohet nga shtojca nr.1 "Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë", bashkëlidhur këtij ligji dhe që është pjesë përbërëse e tij.

Në nenin 5, ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2027, përjashtimisht nenit 3, që i fillon efektet nga data 1 janar 2030, ndërsa fjalia e dytë, e pikës 6, të këtij neni, i fillon efektet nga data 1 janar 2033.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij akti ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave.

Ky projektligj si pjesë e Paketës Fiskale 2027 është konsultuar në Këshillin Tatimor, në mbledhjen e datës 19 tetor 2026, në bazë të nenit 38/1, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Anëtarët e Këshillit Tatimor janë përfaqësues të një grupi të gjerë biznesesh, shoqatash dhe dhomash tregtie, çka siguron një proces konsultimi gjithëpërfshirës dhe përfaqësues, duke reflektuar interesat e sektorëve kryesorë të ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE I SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi dhe zbatimi i projektligjit parashikohet të sjellë efekte pozitive në të ardhurat buxhetore, si rezultat i rritjes graduale të normave të akcizës e akcizës mbi cigaret dhe produktet e tjera të duhanit, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave, shoqëruar me efekte plotësuese pozitive edhe nga TVSH-ja.

Konkretisht, nga kalendari për produktet e duhanit parashikohet një efekt në të ardhura rreth 2.24 miliardë lekë nga akciza dhe rreth 448 milionë nga TVSH-ja, në total rreth 2.69 miliardë lekë. Nga ndryshimi i taksimit për produktin e akcizës biodiesel me vajra nafte, të kategorisë E460, parashikohet një efekt në të ardhura rreth 1.19 miliardë lekë nga akciza, gjithashtu 239.28 milionë nga TVSH-ja, në total rreth 1.43 miliardë lekë. Efekti total në buxhetin e shtetit për vitin 2027, parashikohet rreth 4.12 miliardë lekë.

KËSHILLI I MINSTRAVE